



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

KOMISIONI I PËRHERSHËM I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

Nr. 731/3 prot.

Tiranë, më 19. 03.2026

VENDIM

Nr. 20, datë 19. 03.2026

PËR

MIRATIMIN E SEKRETARIT TEKNIK TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË
PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

Në bazë të nenit 3, 46, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimit nr. 112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Vendimit nr. 777, datë 26.12.2018 të “Për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 5, 32, 33, të Statutit dhe nenit 23 të Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm dhe Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, si dhe shkresës nr. 680/1 prot., datë 17.03.2026 të Rektorit të UMT-së “Përgjigje shkresës suaj nr. 680 prot., datë 13.03.2026”, Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026, pas diskutimeve përkatëse;

VENDOSI:

1. Miratimin e Znj. Ketrin Dushku, në pozicionin e Sekretarit Teknik të Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik.
2. Vendimi t’i njoftohet Rektoratit dhe njësisë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI
PROF. ELIZANA ZAIMI

